KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 334 Nr. i faq/Br.str/No.pg 128
Data/Datum/Date 20 /

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës: 29.3.2017 dhe në bazë të Kontratës për shërbime - Hartimi i Planit Komunal për energji të qëndrueshme, me Nr.295, të datës: 15.3.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## PËR FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR OFRIMIN E TË DHËNAVE PËR ENERGJI TË QËNDRUESHME

1. Me këtë vendim, formohet grupi punues për ofrimin e të dhënave për energji të qëndrueshme, në Komunën e Rahovecit, në përbërje prej:

   1.1. Përparim Krasniqi (Drejtoria për Shërbime publike), kryesues;
   1.2. Besnik Hoti (Drejtoria për Administratë ), anëtar;
   1.3. Avni Morina (Drejtoria për Arsim ), anëtar;
   1.4. Afrim Limani (Drejtoria për Buxhet dhe Financa ), anëtar;
   1.5. Erhan Morina (Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ), anëtar;
   1.6. Saranda Sallteku (Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale), anëtare;
   1.7. Afrim Dina (Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ), anëtar;
   1.8. Berat Duraku (Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rrural ), anëtar;
   1.9. Nora Boshnjaku (Drejtoria për Inspektim ), anëtare;
   1.10. Fatmir Hoti (zyrtar për tatim në pronë ), anëtar;
   1.11. Diellza Çanta (zyrtare për efiçiencë ), anëtare.

2. Anëtarët e Grupit punues kanë për detyrë që të ofrojnë mbështetje për ofrimin e të dhënave për energji të qëndrueshme, në Komunën e Rahovecit.

3. Grupi punues do t'i kryejë punët duke u bazuar në rregullativën në fuqi dhe punët duhet t'i përfundojnë në një afat prej **4 Muajsh - 14.7.2023.**

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Grupit punues dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

5. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

***U dërgohet :***
- ***Anëtarëve të Grupit punues,***
- ***Drejtorisë për Shërbime Publike,***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 336 Nr. i faq/Br.str/No.pg 128
Data/Datum/Date 22/3/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve në hapësira publike - Ritenderim", me Nr. prokurimi: 623-23-1404-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-007-1-2-1 të datës: 20.03.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Faik Thaqi, kryesues
    **1.2.** Gërmia Gashi, anëtare
    **1.3.** Enise Dina, anëtare

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve në hapësira publike - Ritenderim", me Nr. prokurimi: 623-23-1404-2-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-007-1-2-1 të datës: 20.03.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 337 Nr. i faq/Br.str/No.pg 128
Data/Datum/Date 22 / 3 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 53, paragrafit 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/2902/22, i datës 28.10.2022 për caktimin e komisionit për vlerësimin e inventarit**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/2902/22, i datës 28.10.2022 për caktimin e komisionit për vlerësimin e inventarit.

2. Pika 1.2 e vendimit bazik, ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

   **1.3.** Artan Asllani, anëtar.

3. Pikët e tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 02/2902/22, i datës 28.10.2022, mbesin të pandryshuara.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Me vendimin 02/2902/22, e datës 28.10.2022, është caktuar anëtar i komisionit për vlerësimin e inventarit të zyrës së Sindikatës së Pensionistëve dhe të Invalidëve të Punës dhe të Moshuarve të Komunës së Rahovecit.

Duke marrë parasysh se Asllan Mazreku, i cili me vendimin bazik është caktuar anëtar i komisionit, nuk mund të jetë pjesë e këtij komisioni, është i domosdoshëm zëvendësimi i tij dhe caktimi i Artan Asllanit si anëtar i komisionit.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Z. Artan Asllanit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 338 Nr. i faq/Br.str/No.pg 128
Data/Datum/Date 22 / 3/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. **SALI BEHLULIT** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Shef i kontabilitetit, në Drejtorinë komunale për Arsim, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS,** nga data 5.4.2023.

2. OBLIGOHET Drejtoria për Buxhet dhe Financa që punëtorin ta largojë nga lista e pagave, nga data 5.4.2023.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Punëtori **SALI BEHLULIT** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Shef i kontabilitetit, në Drejtorinë komunale për Arsim, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS,** nga data 5.4.2023.

Sipas detyrës zyrtare, Njësia e personelit ka konstatuar se punëtori i lartpërmendur, me datën 4.4.2023 arrin moshën e pensionimit, ngase i bën 65 vjet.

Prandaj, Kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve, vërtetoi gjendjen faktike dhe vendosi që punëtorit Sali Behluli, nga data 5.4.2023, **I PËRFUNDON** marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit.

Nga sa u tha më lart, Kryetari i Komunës, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi, punëtori ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

***Kopja e vendimit u dorëzohet:***
*1. Punëtorit,*
*2. Drejtorisë për Arsim,*
*3. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
*4. Dosjes personale,*
*5. Arkivit.*

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 339 Nr. i faq/Br.str/No.pg 128
Data/Datum/Date 22/3/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës: 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së", me Nr. prokurimi: 623-23-1282-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-019-1-2-1, të datës: 20.3.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Bajram Sokoli, kryesues,
   **1.2.** Etnik Popaj, anëtar,
   **1.3.** Sylejman Kadiri, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së", me Nr. prokurimi: 623-23-1282-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-019-1-2-1, të datës: 20.3.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
p.f.
**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 340 Nr. i faq/Br.str/No.pg 128
Data/Datum/Date 22 / 3 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008")*, nenit 63, 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës: 29.3.2017, në përputhje me Thirrjen Publike për Aplikim me Nr. Prot. 366, të datës: 3.2.2023 për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të në fushën e kulturës nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe vendimit të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të mbi bazën e thirrjes publike, me Nr. Prot. 33, të datës: 10.3.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për ekzekutimin e mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në fushën e kulturës nga Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport

1. Me këtë vendim, **lejohet** ekzekutimi i mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në fushën e kulturës, duke u bazuar në Thirrjen Publike për Aplikim me Nr. Prot. 366, të datës: 3.2.2023, të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe vendimit të Komisionit me Nr. Prot. 33, të datës: 10.3.2023 për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të mbi bazën e thirrjes publike.
2. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### Arsyetim

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shpallur Thirrjen publike për aplikim për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e kulturës, duke iu përmbajtur dispozitave të Rregullores MF-NR- 04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
Pas kësaj, është caktuar Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, mbi bazën e thirrjes publike për aplikim, me Nr. Prot. 02/218/23, i datës: 24.2.2023.
Komisioni, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve, ka marrë vendim me Nr. Prot. 33, të datës: 10.3.2023 dhe ka shpallur fituese OJQ-të, të cilat kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e caktuara për të qenë përfituese të subvencioneve në fushën e kulturës.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI / RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 341 Nr. i faq/Br.str/No.pg 128
Data/Datum/Date 22/3/23
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008")*, nenit 63, 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës: 29.3.2017, në përputhje me Thirrjen Publike për Aplikim me Nr. Prot. 367 të datës: 3.2.2023 për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, në fushën e rinisë dhe të sportit nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe vendimit të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të mbi bazën e thirrjes publike me Nr. Prot. 32, të datës: 10.3.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

**Për ekzekutimin e mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në fushën e rinisë dhe të sportit nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport**

1. Me këtë vendim, **lejohet** ekzekutimi i mjeteve financiare për përfituesit e subvencioneve në fushën e rinisë dhe të sportit, duke u bazuar në Thirrjen Publike për Aplikim me Nr. Prot. 367, të datës: 3.2.2023 të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe vendimit të Komisionit Nr. Prot. 32, të datës: 10.3.2023 për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, mbi bazën e thirrjes publike.
2. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## Arsyetim

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka shpallur Thirrjen publike për aplikim për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e kulturës, duke iu përmbajtur dispozitave të Rregullores MF-NR- 04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
Pas kësaj, është caktuar Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Aplikacioneve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, mbi bazën e thirrjes publike për aplikim me Nr. Prot. 02/215/23, i datës: 24.2.2023.
Komisioni, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve, ka marrë vendim me Nr. Prot. 32, të datës: 10.3.2023 dhe ka shpallur fituese OJQ-të, të cilat kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e caktuara për të qenë përfituese të subvencioneve në fushën e rinisë dhe të sportit.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS / RAHOVEC ORAHOVAC / REPUBLIKA KOSOVA / OPŠTINA ORAHOVAC / PREDSEDNIK / REPUBLIC OF KOSOVA / MUNICIPALITY ...

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 343 Nr. i faq/Br.str/No.pg 129
Data/Datum/Date 23/3/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës: 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me material higjieniko - sanitar", me Nr. prokurimi: 623-23-1564-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-023-1-2-1, të datës: 23.3.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jeton Krasniqi, kryesues,
   **1.2.** Gërmia Gashi, anëtare,
   **1.3.** Enise Dina, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Furnizim me material higjieniko - sanitar", me Nr. prokurimi: 623-23-1564-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-023-1-2-1, të datës: 23.3.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL MAYOR
REPUBLIC OF KOSOVO
RAHOVEC
ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 351 Nr. i faq/Br.str/No pg 129
Data/Datum/Date 27/3/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, nenit 49 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Kërkesës së punëtores, të miratuar nga eprori i drejtpërdrejtë, si dhe nenit 92, të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M
**Për dhënien e pushimit të lehonisë**

1. **Znj. Leonora Koçinaj**, nga Prizreni, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për Mirëqenie Sociale, në Qendrën për Punë Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në Komunën e Rahovecit, i aprovohet pushimi i lehonisë, në kohëzgjatje prej 12 muajsh, sipas dispozitave të përcaktuara me Ligjin e Punës Nr. 03/L-212.
2. E lartpërmendura, sipas Ligjit të Punës, 6 (gjashtë) muajtë e parë të pushimit të lehonisë do te paguhet nga punedhenesi me kompensim 70% te pages baze, nga data: 15.3.2023, deri më: 15.9.2023. Ndërsa, 3 (tre) muajtë në vijim, pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës, me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë, nga data: 16.9.2023, deri më: 16.12.2023. Ndërsa, 3 muajtë e tjerë do të jenë pa pagesë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

## A r s y e t i m

Punonjësja **Leonora Koçinaj**, nga Prizreni, e cila është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe e sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtare për Mirëqenie Sociale, në Qendrën për Punë Sociale, në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, se nga data 15.3.2023, do të shkojë në pushim të lehonisë, sipas fletëlëshimit të datës 24.3.2023, të "Spitalit Amerikan"
Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Nëpunësja ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nga dita e marrjes së këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Znj. Leonora Koçinaj,***
- **Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,**
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Dosjjes së punëtores,***
- **Njësisë së personelit.**

***Smajl Latifi***

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 352 Nr. i faq/Br.str/No.pg 130
Data/Datum/Date 27 / 3 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, nenit 4 paragrafi 4, neni 8 paragrafi 5 dhe 8, nenit 11 dhe nenit 21 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017 dhe rekomandimit të komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për ndihma momentale me Nr. Prot. 99 i datës 27.03.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
### Për ndarje të subvencioneve për ndihma momentale

1. **MIRATOHET** rekomandimi i Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndihma momentale në fushën e shëndetësisë dhe ndahen subvencione për 140 (njëqind e dyzet) përfitues të cilët i kanë plotësuar kriteret sipas Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvecioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është lista prej 140 (njëqind e dyzet) përfituesve të ndihmës mometale të rekomanduar nga Komisoni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave në shumë të përgjithshme prej 27,200.00€ (njëzet e shtatë mijë e dyqind euro).

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC
ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 353 Nr. i faq/Br.str/No.pg 130
Data/Datum/Date 27/3/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Rrënimi i objekteve pa leje në Komunën e Rahovecit" me numër të kontratës 623-21-5827-5-2-1/C339 si në vijim:

   **1.1** z. Venhar Topalli, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për shërbime publike pranë Drejtorisë për Shërbime Publike në Komunën e Rahovecit, **CAKTOHET** menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2** z. Afrim Limani, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/1315/21 i datës 9.12.2021.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit.***
- ***Drejtoria për Inspektim, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR'S OFFICE
Njësia/Jedinica/No Unit: Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr. 356 Broj/Br.str/No.pg 130
Data/Datum/Date 27.3.23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-40 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 14 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të dates 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] dhe i **LEJOHET** pagesa e shpenzimeve të udhëtimit për vajzën e tij, [redacted], në relacionin Pastasel - Rahovec, për vijimin e mësimit në IAAP "Selajdin Mullaabazi - Mici" në Rahovec, në shumën prej **30 eurosh** në muaj, duke filluar nga data **1 mars 2023, deri më 30 qershor 2023.**

2. Mjetet do të sigurohen nga pozicioni i subvencioneve në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa dhe Buxhet, dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

4. Vendimi hyn në fuqi nga dita e miratimit të tij.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Drejtorisë për Financa dhe Buxhet,*
- *Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,*
- [redacted] *nga Pastaseli,*
- *Arkivit.*

**Smajl Latifi**

**Kryetari i komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 358 ... fq/Br.str/No.pg 130
Data/Datum/Date 27.3.23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, dispozitave të Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 18/2011")*, dispozitave të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kontratës me titull "Projekti i ndërtimit të Sheshit Qendror në Rahovec" me Nr. të Prokurimit 623-22-6778-5-1-1, Kërkesës me Nr. Prot. 87 të datës 27.3.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
## Për ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në kontratën me titull "Projekti i ndërtimit të Sheshit Qendror në Rahovec"

1. Me këtë vendim **lejohet** ndërrimi (kolaodimi) i pozicioneve të situacionit nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Projekti i ndërtimit të Sheshit Qendror në Rahovec" me Nr. të Prokurimit 623-22-6778-5-1-1.

2. Ndërrimi i pozicioneve sipas pikës 1 të këtij vendimi do të bëhet nga pozicionet e kontratës Nr. 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 3.7, 3.8, 3.9, 3.10, 3.11 dhe 4.1 në pozicionin e ri të domosdoshëm për realizim për ndërtimin (rikapitullimin) e murit mbrojtës, pa implikime shtesë financiare.

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Prokurimit, Ekipi për Menaxhimin e Kontratës dhe Organi Mbikëqyrës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Ofruesi i shërbimeve (punëkryesi) i kontratës me titull "Projekti i ndërtimit të Sheshit Qendror në Rahovec" me Nr. të Prokurimit 623-22-6778-5-1-1 i ka rekomanduar Ekipit për Menaxhimin e kontratës ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve në këtë kontratë, me qëllim të ndërtimin (rikapitullimin) e murit mbrojtës.

Pas kësaj, Ekipi për Menaxhimin e Kontratës, përmes Mbikëqyrisit të drejtpërdrejtë ka parashtruar kërkesën me Nr. Prot. 87 të datës 27.3.2023, me anë të së cilës ka kërkuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ ndërrimin (kolaodimin) e pozicioneve nga një pozicion në tjetrin, në kontratën me titull "Projekti i ndërtimit të Sheshit Qendror në Rahovec" me Nr. të Prokurimit 623-22-6778-5-1-1 dhe atë nga pozicionet e kontratës Nr. 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, 3.7, 3.8, 3.9, 3.10, 3.11 dhe 4.1 në pozicionin e ri të domosdoshëm për realizim për ndërtimin (rikapitullimin) e murit mbrojtës, pa implikime shtesë financiare.

Ky ndërrim (kolaodim) i pozicioneve është bërë me qëllim të ndërtimit (rikapitullimit) të murit mbrojtës në këtë projekt dhe me të cilin është rënë dakord me Operatorin Ekonomik dhe me Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtëpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës që të bëhet pa implikime financiare.

Pas konsultimit me Sektorin e Prokurimit, Ekipin për menaxhimin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtëpërdrejtë, si dhe pas vlerësimit të fakteve në shkresat e lëndës, është vendosur për ndërrim të pozicioneve në kontratën e lartpërmendur.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Ekipit për Menaxhimin e Kontratës,***
- ***Mbikëqyrësit të Drejtëpërdrejtë,***
- ***Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,***
- ***Njësisë së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 259 Nr. i faq/Br str/No.pg 130
Data/Datum/Date 28 / 3 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës: 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me inventarë për nevojat e Komunës së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP-së", me Nr. prokurimi: 623-23-1684-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-021-1-2-1, të datës: 27.3.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Faik Thaqi, kryesues,
    **1.2.** Gërmia Gashi, anëtare,
    **1.3.** Vjollca Berisha, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Furnizim me inventarë për nevojat e Komunës së Rahovecit, të cilat nuk janë të përfshira në kontratat e AQP-së", me Nr. prokurimi: 623-23-1684-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-021-1-2-1, të datës: 27.3.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 360 Nr. i faq/Br.str/No.pg 130
Data/Datum/Date 28/ 3 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës: 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Vendosja e tabelave për emërtim të rrugëve, parqeve dhe shesheve", me Nr. prokurimi: 623-23-1686-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-024-5-2-1, të datës: 27.3.2023, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jeton Krasniqi, kryesues,
   **1.2.** Antigona Krasniqi, anëtare,
   **1.3.** Enise Dina, anëtare.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin "Vendosja e tabelave për emërtim të rrugëve, parqeve dhe shesheve", me Nr. prokurimi: 623-23-1686-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-024-5-2-1, të datës: 27.3.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
pel.
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr/Br/No 361 Nr. i faq/Br str/No.pg 131
Data/Datum/Date 28/3/23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës: 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës: 29.3.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës**

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, me titull: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Rahovecit", me numër të kontratës 623-23-723-2-2-1/C462, si në vijim:

   1.1. Z. Besnik Hoti, Drejtor i Drejtorisë për Administratë, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   1.2. Z. Afrim Limani, Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës: 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Administratë, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 363 Nr. i faq/Br.str/No.pg 131
Data/Datum/Date 28 / 3 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës: 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Ndërtimi i e-kioskut”, me Nr. prokurimi: 623-23-1712-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-026-5-2-1, të datës: 28.3.2023, në këtë përbërje:

    **1.1.** Egzon Thaqi, kryesues,
    **1.2.** Vjollca Berisha, anëtare,
    **1.3.** Meriton Gashi, anëtar.

2. Komisioni ka për detyrë ta bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Ndërtimi i e-kioskut”, me Nr. prokurimi: 623-23-1712-5-2-1 dhe Nr. të brendshëm: 623-23-026-5-2-1, të datës: 28.3.2023.

3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do ta fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KOMUNË/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 366 Nr. i faq./Br.str./No.pg 131
Data/Datum/Date 30/3/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008")*, nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës *("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 14/2019")*, nenit 5 dhe nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 06/2022 për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës: 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për themelimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës**

1. Me këtë vendim, **themelohet** Ekipi për të Drejtat e Fëmijës, në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
   **1.1.** Smajl Latifi – Kryetar i Komunës, kryesues,
   **1.2.** Saranda Sallteku – Drejtore e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare,
   **1.3.** Avni Morina – Drejtor i Drejtorisë për Arsim, anëtar,
   **1.4.** Shemsije Deliu - Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare,
   **1.5.** Qemajl Krasniqi – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar,
   **1.6.** Ekrem Bytyqi – Drejtoria për Buxhet dhe Financa, anëtar,
   **1.7.** Defrim Kafexhiu – Përfaqësues i Komitetit për Politikë dhe Financa, anëtar,
   **1.8.** Bajram Morina – Përfaqësues i Komitetit për Komunitete, anëtar,
   **1.9.** Habibe Haxhimustafa – Njësia për të Drejtat e Njeriut, anëtare,
   **1.10.** Qerim Hoti – Përfaqësues i Policisë së Kosovës, anëtar,
   **1.11.** Hyrmete Topalli – Qendra për Punë Sociale, anëtare,
   **1.12.** Adelina Paqarizi – Përfaqësuese nga Shoqëria Civile, anëtare.

2. Në cilësinë e anëtarëve vëzhgues dhe të këshilltarëve të jashtëm, janë:
   **2.1.** Blerina Hajda – Përfaqësuese e fëmijëve, anëtare,
   **2.2.** Erseka Cana – Kryetare e Këshillit të Prindërve, anëtare,
   **2.3.** Mark Kaçinari – Përfaqësues nga Zyra e Rajonale e Institucionit të Avokatiti të Popullit, anëtar,
   **2.4.** Vjollca Gurgule – Përfaqësuese e Organizatës SHL - Kosova, anëtare.

3. Njësia për të Drejtat e Njeriut, në Komunën e Rahovecit, do të shërbejë si Sekretariat i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, e cila do të bëjë përgatitjen e materialeve të takimeve; Mbajtjen e procesverbaleve dhe përgatitjen e raporteve; Arkivimin e dokumenteve që dalin nga puna e Ekipit dhe Mledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga anëtarët e Ekipit dhe raportimin për zbatimin e politikave për të Drejtat e Fëmijës.

4. Detyrat dhe përgjegjësit e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës dhe Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 06/2022, për themelimin dhe funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdesen anëtarët e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe Njësia për të Drejtat e Njeriut, në Komunën e Rahovecit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendim u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Ekipit,***
- ***Njësisë për të Drejtat e Njeriut,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 369 Nr. i faq/Br.str/No.pg 131
Data/Datum/Date 31 / 3 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70 paragrafi 70.18 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

## V E N D I M
### Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Hartimi i projekteve të ndryshme në Komunën e Rahovecit" me numër të kontratës 623-23-321-2-1-1/C463, si në vijim:

   **1.1** z. Shpejtim Mustafa, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Arkitekt, pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

   **1.2** z. Albnor Mullabazi, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, **CAKTOHET** mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Menaxheri i kontratës,***
- ***Mbikëqyersi i drejtpërdrejtë,***
- ***Sektori i Prokurimit,***
- ***Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**
**Zyrtar Kryesor Administrativ**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. 370 Nr. i faq/Br.str/No.pg 131
Data/Datum/Date 31 / 3 / 23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/297/23 i datës 15.3.2023 për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/297/23 i datës 15.3.2023 për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me teknologji informative – sistemi për menaxhimin e radhës, digital sender dhe pjesë të teknologjisë informative", me Nr. prokurimi: 623-23-1171-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-018-1-2-1 të datës: 14.03.2023.

2. Pika 1.1 e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

   **1.1** Faik Thaqi caktohet kryesues i komisionit, në vend të Arbnor Kabashi.

3. Pikët tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 02/297/23 i datës 15.3.2023 mbesin të pandryshuara.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### *Arsyetim*

Me vendimin 02/297/23 i datës 15.3.2023 është caktuar komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin "Furnizim me teknologji informative – sistemi për menaxhimin e radhës, digital sender dhe pjesë të teknologjisë informative", me Nr. prokurimi: 623-23-1171-1-2-1 dhe Nr. të brendshëm 623-23-018-1-2-1 të datës: 14.03.2023.
Duke marrë parasysh se Arbnor Kabashi, i cili me vendimin bazik është caktuar kryesues i komisionit gjendet në pushim vjetor, është i domosdoshëm zëvendësimi i tij dhe caktimi i Faik Thaqi kryesues i komisionit.
Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Z. Faik Thaqi,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
372 Nr. i faq/Br.str/No.pg 132
31/3/23

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për qasje në dokumente publike**

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/345/23, e datës 24.3.2023 për qasje në dokumente publike nga znjsh. Diana Metushi Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, dhe atë:

   **1.1.** Raporti i muajit Dhjetor 2022 për pagat e asambleistëve komunal;
   **1.2.** Buxheti i DKA për secilin institucion arsimor për vitin 2022.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Arsyetim***

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/345/23, e datës 24.3.2023 për qasje në dokumente publike nga znjsh. Diana Metushi Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), për qasje në dokumente publike.
Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtës i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë: Raporti i muajit Dhjetor 2022 për pagat e asambleistëve komunal dhe Buxheti i DKA për secilin institucion arsimor për vitin 2022.
Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.
Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimit të tij.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,***
- ***z. Diana Metushi Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVACA
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kry...)
Nr./Br./No 373 Nr. i faq/Br.str 132
Data/Datum/Date 31/3/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008")*, nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe kërkesës së znj. Bukurije Ramadani me Nr. Prot. 1063 të datës 20.3.2023, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

# VENDIM
## Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet** kërkesa për pushim pa pagesë e znj. Bukurije Ramadani nga fsh. Opterushë Komuna e Rahovecit, me Nr. Personal të leternjoftimit 123127812, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Assistente Administrative, pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, respektivisht nga data 1.4.2023 deri me date 1.10.2023.

2. Të lartpërmenduriës në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Obligohet Zyrtari/ja për paga në Komunën e Rahovecit që ta largoj nga lista e pagës znj. Bukurije Ramadani për periudhën e lartcekur.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit, Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### *A r s y e t i m*

znj. Bukurije Ramadani, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Assistente Administrative, pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot. 1063 të datës 20.3.2023, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, respektivisht nga data 1.4.2023 deri me date 1.10.2023.

Kërkesën e lartpërmendura e ka parashtruar pasi, bashkëshorti për një periudhë është jashtë vendit dhe e njëjta është e obliguar që të kujdeset për fëmijën e tyre dhe për këtë arsye e lartpërmendura është e detyruar të kujdeset për të.

Duke marrë parasysh se e lartpërmendura jeton vetëm me nënën e bashkëshortit, e cila është e plakur dhe nuk mund të kujdeset për veten e sajsi dhe kujdesin e fëmijës së vogël, është e domosdoshme dhënia e pushimit mjekësor pa pagesë për Bukurije Ramadani.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmenduriës i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 16 të Rregullores (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrtarja publike ta shfrytëzoj pushimin pa pagesë, për përkujdesjen e shëndetit të nënës së saj dhe fëmijës.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Znj. Bukurije Ramadani nga fsh. Opterushë,***
- ***Drejtoria për Administratë,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrtari/ja për paga,***
- ***Njësia e Personelit, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**